

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o., me seli në adresën Tadije Sondermajera nr.5, 17, apartamenti nr.152, Beograd, Republika e Serbisë, dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Konstantinoviç dhe Miloshevski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.01.2025, ka marrë këtë:

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin FLJUS DOO BEOGRAD d.o.o., me seli në adresën Tadije Sondermajera nr.5, 17, apartamenti nr.152, Beograd Republika e Serbisë, synon të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë BEN AIR SHPK BEOGRAD (SAVSKI VENEC), Andre Nikoliq nr.3., Beograd, Republika e Serbisë përmes blerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më datë 29.11.2024 dhe plotësuar më datë 20.12.2024 deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Komisioni) është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o., me seli në adresën Tadije Sondermajera nr.5 ,17 ,apartamenti nr.152 ,Beograd Republika e Serbisë me të cilin FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o., synon të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë BEN AIR SHPK BEOGRAD (SAVSKI VENEC), Andre Nikoliq nr.3., Beograd Republika e Serbisë përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

FLJUS DOO BEOGRAD d.o.o është themeluar më datë 6 mars 2024 në Republikën e Serbisë për kryerjen e transportit ajror të pasagjerëve. Kompania aktualisht është ende në fazën e përgatitjes së aktiviteteve dhe nuk ofron asnjë shërbim palëve të treta apo realizon fitime.

FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. njëkohësisht i përket grupacionit DELTA HOLDING, i cili është aktiv në Serbi dhe rajon në një numër të madh fushash të ndryshme të veprimtarisë afariste, si dhe grupit EL&MI Group, i cili gjithashtu është aktiv në disa fusha të ndryshme të veprimtarisë afariste. Konkretisht, pronar i 50% të pjesëve në FLJUS SHPK BEOGRAD d.o.o. Beograd është AIRSTAR SHPK BEOGRAD (që është pjesë e grupit DELTA HOLDING), ndërsa 50% e pjesëve të tjera janë në pronësi të EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD.

FLJUS DOO BEOGRAD d.o.o. Beograd nuk ka shoqëri të varur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

DELTA HOLDING GROUP, kompanitë nga grupi "Delta Holding" kryejnë aktivitetet e tyre në fushën e prodhimit bujqësor, prodhimit të ushqimit, eksportit, importit dhe përfaqësimit të kompanive të huaja, shpërndarjes së mallrave për konsum të gjerë, shitjes së automjeteve, zhvillimit të pronave dhe zhvillimit të teknologjive të reja.

Delta Holding Group i realizon aktivitetet e saj afariste përmes pesë njësive organizative: Delta Agrar Group, Delta përpunimi i ushqimit, Delta grupi i pasurive të paluajtshme, Delta shpërndarje dhe departamenti për teknologji të reja.

Përveç tregut serb, Delta Holding Group është e pranishme edhe në një numër tregjesh në rajon dhe Bashkimin Evropian.

Delta Holding Group ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ato janë:

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ANANAS MK SHPK Shkup, me seli në rrugën Stoltenbergova nr.4/l.V/DP1, Qendër, Shkup, me veprimtari të regjistruar – ndërmjetësim në tregtinë me produkte të ndryshme dhe

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ANANAS SHOP SHPKNJP Shkup me seli në rrugën Stoltenbergova nr.4/l.V/DP1, Qendër, Shkup me veprimtari të regjistruar – tregti me pakicë përmes postës dhe internetit.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD është themeluar më 24 maj 2012 në Republikën e Serbisë. Veprimtaria kryesore është prodhimi i energjisë elektrike (kodi i veprimtarisë: 35.11).

Ka pozicionin e kompanisë mëmë brenda një grupi kompanish me pronësi si kompani holding në kuptimin praktik. Brenda grupit ka disa kompani që merren me veprimtari ekonomike të ndryshme.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD aktualisht nuk operon në tregun serb, duke pasur parasysh që kompania SOFT WHITE SHPK BEOGRAD, nga GRUPI EL&MI, ka ndaluar kryerjen e veprimtarisë së transportit ajror të pasagjerëve dhe gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë aktivitet afarist.

EL&MI GROUP D.O.O. BEOGRAD nuk ka shoqëri të varura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BEN AIR SHPK BEOGRAD, shoqëria e synuar është themeluar më 24 mars 2009 në Republikën e Serbisë.

Shoqëria e synuar nuk ka shoqëri të varur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ